

SALAJDIN SALIHU ARMËTARIA NË TETOVË

623.41-05''16/18''(497.751)

Abstrakti: Mjeshtëria e prodhimit të armëve të zjarrit te shqiptarët është e njojur nga shekulli XVII, por u zhvillua një shekull më vonë. Tetova ishte qendër kryesore për prodhimin e armëve që u përdorën nga kryengritësit shqiptarë dhe ballkanas. Në shekullin XIX Porta e Lartë i ndaloj prodhuesit privat të armëve. Shumë punëtori u mbyllën dhe kjo ndikoi në pozitën sociale të banorëve që jetonin nga ky profesion. Pushkët e Tetovës njiheshin për bukurinë e tyre. Armët dekoroheshin me serm, ar e sedef. Mjeshtrit tetovarë ishin të aftë t'i kopjonin pushkët e njoitura, të prodhuan në vende të ndryshme të Europës nëpërmjet një teknologje të avancuar.

Fjalët kyçë: Tetova, armëtaria, martinat, arnautkat

Armëtaria u zhvillua te shqiptarët nga fundshekulli XVIII dhe fillimshekulli XIX. Fillimi ishte Dibra një bazë kalimtare e shpërndarjes së armëve drejt rajoneve të tjera dhe njihej për prodhimin e pistoletave cilësore, që më pas prodhoheshin në Tetovë, veçmas lloji "Kalkandelen".

Në shekullin XIX Tetova u bë qendër e rëndësishme shqiptare për prodhimin e armëve, që kërkoheshin në Ballkan e më gjerë. Njëra prej armëve më të njoitura ishte "Arnautka", e cila në Prizren njihej si "çakmak". "Arnautkat" punoheshin nga çeliku i farkëtar, ishin pushkë të gjata, sikurse karajfilja (e quajtur edhe "dibransha"). Ami Boue i quan edhe "paftalia".

«Pushkët quhen arnautka (shqiptare) ose paftalia, peshojnë nga 11 e 12 libra (libra është rrëth 460 gr) dhe tytat janë të gjata 5 këmbë dhe 4 këmbë (masë)¹, shkruan Boue.

Sipas baronit Nopcsa këto ishin pushkë me originë nga Ballkani perëndimor dhe karakteristike për shqiptarët. Kjo pushkë hasej në fund të shekullit XVII në Shqipëri dhe në Mal të Zi, kurse në shekullin XVIII ishte përhapur në të gjithë vendet e Turqisë Europeane².

Pushkët e Tetovës u përdorën nga kryengritësit shqiptarë gjatë periudhës së Lidhjes së Prizrenit, në kryengritjet e viteve 1910-1912 dhe më pas³, por janë përdorur edhe nga popujt tjerë, veçmas nga bullgarët. Nikolla Pushkarov, në kujtimet e tij, shkruan se pushkët për vrhovistët ishin sjellë nga Tetova. Gjorçe Petrovi, po ashtu, thotë se martinat e blera ishin prodhuar në Tetovë dhe Dibër. Martinat tetovare përmenden edhe në shënimet e Jane Sandanskit etj⁴. Revista bullgare "Ilustracija Ilinden", e botuar më 1939, shkruan: "Më 1908, në pjesën e epërme të Tetovës, shqiptarët prodhuan në punëtoritë e tyre primitive pushkët e quajtura "martina" me të cilat janë shërbyer kryengritësit bullgarë"⁵.

¹ Ami Boué, *La Turquie d'Europe...* Paris 1840, f. 226.

² Проф. др Радован Радовановић, Мр Небојша Ђокић, "Стрелачко оружје оријенталног порекла у наоружању полиције у Србији у првој половини XIX века,, , нё: Записи, Гогишњак историјског архива Пожаревац, Вити V, Numëر 5, Pozharevc, 2016, f. 73-83.

³ Vilma Nallbani, "Tradita muzeale – arkivore në Shqipëri, ruajja dhe evidentimi i saj: modeli i arkivit të kulturës materiale në Institutin e Antropologjisë kulturore", Arkivi Shqiptar 1-2, Viti XVIII, Tiranë, 2017, f.81

⁴ Л. Милетич, *Движението отсамът Вардар и борбата съ върховистите...*, libri VII, Sofje, 1927

⁵ Гр. Тетово, *Ilustracija Ilinden*, viti XI, nr.4 (104), Sofje, prill 1939, f.13.

Pushkët e Tetovës njiheshin për bukurinë e tyre. Një martinë e vitit 1894, e punuar në Tetovë, është ekspozuar në Ekspozitën Universale të Çikagos, kurse një armë tjetër tetovare e shekullit XIX, ruhet në Muzeun e Uashingtonit. Pushkët tetovare shpesh dekoroheshin me serm, ar e sedef. Mjeshtrit tetovarë ishin të aftë t'i kopjonin pushkët e njohura, që prodhoheshin në Europë me teknologji të avancuar. Tetovarët e kopjuan pushkën "Henry - Martiny", që prodhohej në Britaninë e Madhe dhe u shfrytëzua edhe në Ballkan, sepse ishte më e lirë se sa pushkët tjera. Pushka kishte mekanizëm të mbyllur dhe ishte ideuar nga Fridrih fon Martini. Ajo nisi të përdorej nga ushtria britanike në vitin 1871. Martinat filluan të prodhoheshin në Tetovë ndërmjet viteve 1875 dhe 1880. Tetovarët prodhonin edhe pushkë të sofistikuara, që mund të fshiheshin nën pallto. Zakonisht me tyta të shkurtuara.

Autori turk Sulejman Kylçe shkruan se në Tetovë, rrëth vitit 1786, prodhoheshin rrëth 224 pushkë në ditë, në 450 dyqane armëtarësh.

«Historia përmend se në Tetovë, rrëth vitit 1786, ishin 450 punëtori që merreshin me punimin e armëve të zjarrit. Punëtoritë ishin katër llojesh: tytashpues, kasapunes, zbukurues të kasave dhe montues të armës komplet...»¹, shkruan ai.

Në Salnamet e Vilajetit të Kosovës, nga viti 1896, flitet për armëtarinë e zhvilluar në Tetovë. Pushkët e Tetovës krahasoheshin me ato europiane. Ato i bënin të veçanta zbukurimet dhe dalloheshin për mënyrën e shpimit të tytave². Në këtë proces shfrytëzohej energjia e ujit të lumit të Tetovës³.

Gjurgjica Petroniq, në artikullin "Armëtarët e Tetovës", shkruan: «*Pranë këtyre dyqaneve, në tregun e sipërm dhe të poshtëm, pranë lumit Pena të Tetovës, kanë pasur baraka ku shpoheshin tytat e pushkëve me turjela të gjata si të minatorit, duke shfrytëzuar për këtë qëllim energjinë e ujit të lumit. Vendi ku kryheshin shpimet e tytave të pushkëve quhej «Çarga»*⁴.

Në fund të shekullit XIX kishte filluar rënia e prodhimit të martinës tetovare. Sipas kronistik Bullgar, Andrea Stojanovit, rënia e prodhimit të "martinës" kishte ndodhur ngase Porta e Lartë e kishte ndaluar prodhimin e armëve nga prodhuesit privatë.

Shefe Petriti, në shkrimin "Letër nga Shqipëria: Tetova, Gustivari", të dërguar për botim në vitin 1899 dhe të botuar në vitin 1900 në "Ditërrëfenjësin kombiar", veçonte në Tetovë një fabrikë mielli dhe punëtoritë për prodhimin e armëve.

“S’duhet të them sa janë të zotërit Tetovarët për të punuarë hekur e për të bërë armë: bëjnë martina dhe pisqolla të mira; bëjnë nga këto armë si shkop për të mbajtur në dorë, të cilat s’njihenë fare se janë armë. Për të çpuarë hekurin kanë një vegël (çark)”⁵.

Franc Nopçë e paraqet Shqipërinë si panair armësh, ku kryesorja ishte martina, njëra prej të cilave ishte origjinale dhe me radius të gjatë veprimi. Ajo quhej kaçator. Tjetra ishte me radius të shkurtër veprimi. Si qendra të industrisë së martinës përmenden Gjakova dhe Tetova, ku imitoheshin edhe armë të njohura europiane⁶.

Autori serb Svetozar Tomiq në një reportazh të vitit 1906, të botuat në revistën "Nova Iskra", me titull: "Nga Serbia e Vjetër: Shkupi, Tetova, Gostivari, Mavrova", jep të dhëna për Pollogun dhe flet edhe për prodhimin e armëve në Tetovë. Ai shkruan se dikur rajoni i Tetovës njihej për tregtinë e zhvilluar, që kishte pësuar rënie. Zanati që mbetej i suksesshëm ishte ai i prodhimit të pushkëve.

¹ Sulejman Kulca, në *Osmanli tarihinde Arnavutluk (Shqipëria në historinë osmane)*, Izmir 1944, faqe 381 – 384

² Salnâme-i Vilâyet-i Kosova, Yedinci Def'a, Üsküp, 1314 (1896), në faqet 517 dhe 543- 544.

³ "Punimi i armëve të zjarrit nga shqiptarët në shekujt XVIII - XIX", <http://oshtima.org/postimi/153>

⁴ Gjurgjica Petroniq, "Tetovski pushkari", Ohër 1960, f. 117 – 120

⁵ Shefe Petriti, "Letër nga Shqipëria: Tetova, Gustivari", në "Ditërrëfenjësi kombiar", Sofje, 1900, f.73

⁶ Franz Nopcsa «Albanien, Bauten, Trachten und Geräte» Berlin, und Leipzig, 1925

“E gjithë Çarshia e Epërme, në anën e djathtë të Shkumës (Penjavica, siç quhet nga autori – shënim S.S.), është plot me dyqane dhe punëtori ku prodhohen pushkët. Këtu ka 50 punëtori që prodhojnë pushkët e njojura shqiptare: martinat”¹.

Rënia e tregtisë në Tetovë përmendet edhe nga udhëpërshkruesi M. Gajic.

“Është shumë i dëgjuar zanati i prodhimit të pushkëve. Në Bistricë (kështu quhet lumi i Tetovës – shënim S.S.) ka disa punëtori për prodhimin e martinave, që i blejnë shqiptarët. Tetova ka rënë ekonomikisht prej se ka rënë blegtoria, megjithatë arrin të mbahet ende, sepse ka fushë pjellore... Tregtia është e gjallë dhe shumica e tregtisë ka qenë në duar të krishterëve, por tani muhamedanët kanë filluar që t'i ngulfatin të krishterët”, shkruan ai².

Edhe Eqrem bej Vlora, duke e përshkruar Tetovën e vitit 1910, shkruan për armëtarinë në Tetovë:

“Tregu i Tetovës (Kalkandele) që prej kohësh të vjetra ka qenë i njojur si qendër për prodhimin e armëve (320 armëbërës dhe disa qindra ndihmës). Këta zejtari jo vetëm që kishin prodhuar prej shekujsh armë të vjetra, por që nga viti 1883 kishin arritur të kopojnë për mrekulli edhe disa modele armësh moderne. Këto armë mbanin edhe markën e tyre, “Hasan” të gdhendura me shkronja turke në tytë. Një vendim i qeverisë së Turqve të Rinj urdhëronte mbylljen e menjëherëshme të të gjitha këtyre punishteve (në vend që këta mjeshtëra zejtari të ngarkoheshin me prodhim armësh për ushtrinë). Është e qartë qe njerëzit e këtij qyteti të vogël, të cilët denbabaden kishin jetuar krejtësisht prej këtij zanati si dhe për banorët e zonave përreth që aty përplaseshin, për të bërë apo ndrequar armë, ky urdhër ishte një katastrofë dhe do të ndeshte me një kundërshtim të dëshpëruar. Njëkohësisht u mbyllën punishtet e barutit të Matit dhe ato të Dibrës për mbushjen e fishekëve të Martinës. Të gjitha këto masa edhe shumë të tjera, edhe pse të përligjura, por të zbatuara me paftësi të skajshme, bënë që edhe shpirrat më të ftohtë të fillojnë të ziejnë”³.

Përfundim

Mjeshtëria e prodhimit të armëve të zjarrit nga shqiptarët është e njojur nga shekulli XVII, por u zhvillua një shekull më vonë, veçanërisht në Tetovë, që u bë njëra prej qendrave kryesore për prodhimin e armëve, veçanërisht pushkës “martina”. Këto pushkë u përdorën nga kryengritësit shqiptarë dhe të Ballkanit. Shumica e autorëve të shekullit XIX, që shkruajnë për Tetovën, e përmenden mjeshtërinë e armëtarisë në këtë qytet. Mjeshtrit tetovarë njiheshin për mënyrën e prodhimit dhe kopjimin e pushkëve të njoitura europiane. Prodhimi i armëve shënoi rënje në fund të shekullit XIX, sepse Porta e Lartë e ndaloi prodhimit e tyre nga prodhuesit privatë. Mbyllja e punëtorive e vështirësoi edhe pozitën sociale të banorëve që jetonin nga ky profesion.

¹ Св. Томич, “Из Старе Сербије, Скопле – Темово – Гостивар – Маврово”, 1 мај 1906, f.137

² М. Гајић, “С Лепенца на Радику”, Годишњица Николе Чупића, Београд, 1901, f.139

³ Eqrem bej Vlora, *Kujtime (1885 - 1925)*, përktheu Afrim Koçi, Shtëpia e Librit dhe Komunikimit, Tiranë, 2003, f.239.